

VENDIM
Nr.62, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.1093, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin emërtim e numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në pikën 2, fjalët në kllapa “ ... (kolona 2)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 3)... ”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 5) e lidhjes nr.1 jepet 2% pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 % dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për emërtesën “Nëninspektor” shtesa për vjetërsi në punë jepet 1% pas çdo viti pune dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit. ”.

4. Në pikën 4, fjalët në kllapa “ ... (kolona 4)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 6)... ”.

5. Në pikën 5, fjalët në kllapa “ ... (kolona 5)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 7)... ”.

6. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“ 5/1. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 8 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5/2. Numri i punonjësve, për pozicionin “Nëninspektor”, në drejtoritë/sektorët e investigimit, nuk do të jetë më shumë se 30% e numrit të përgjithshëm të punonjësve të drejtorisë/sektorit. ”.

7. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, pagat e të cilëve janë përcaktuar në lidhjen nr.1, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, me akte të tjera të Këshillit të Ministrave.”.

8. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 7. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e të drejtorive rajonale, që kategorizohen në kategoritë D.2 e D.3, përcaktohen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës, në institucionet buxhetore. ”.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e tatimeve, në buxhetin e vitit 2009.

10. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE		SHITESA E POZICIONIT	
Kategoria e vendit të punës	Kategoria e pagës	Paga e Grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	11 000	Drejtor i Përgjithshëm	2%		103 500	20 000
	II-b	11 000	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		86 500	15 000
A	III-a	11 000	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor i Drejtorisë rajonale.	2%		68 500	15 000
B	III-a/1	11 000	Përgjegjës/shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	2%		58 300	14 000
C.1	III-b	11 000	Përgjegjës/shef sektori/zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme	2%		51 500	12 000
	III-b	11 000	Përgjegjës zyre në Taks Forcë	2%		51 500	17 000
C.2	IV-a	11 000	Inspektor i dytë. Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme.	2%		39 000	12 000
	IV-b	11 000	Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Specialist në drejtoritë rajonale.	2%		29 000	10 000
C.3	IV-c	11 000	Specialist.	2%		21 500	5000
D.1	IV-b	11 000	Sekretar në Drejtorinë e Përgjithshme.	2%		29 000	5000
	IV-c	11 000	Sekretar në drejtoritë rajonale	2%		21 500	5000
			Nëninspektor.	1%		25 000	10 000